



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2237/ Prot
2

Rrëshen, më 29 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 42 datë 26. 05. 2026

P Ë R

**“MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT MES BASHKISË MIRDITË,
TË PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI Z. ALBERT MËLYSHI & KOOPERATIVËS
SOCIALE VALES SCS, PËRFAQËSUAR NGA DREJTORI Z. PAOLO FELIN &
CARITAS DIOQEZAN RRËSHEN, PËRFAQËSUAR NGA IPESHKËVI GJERGJ
META PËR KRIJIMIN DHE MENAXHIMIN E QENDRËS DITORE PËR TË
MOSHUARIT NË BASHKINË MIRDITË”**

Në mbështetje të neneve 13, 54, 55, shkronja “dh”, “e” dhe “i”, si dhe nenit 68 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” *i ndryshuar*, ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” *i ndryshuar*, në dispozitat që rregullojnë kontratën e huasë në përdorim (komodato), ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” *i ndryshuar e shtesë*, me ligjin nr. 40/2023, ligji nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” *i ndryshuar*, ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, *i ndryshuar*, VKM nr. 518, datë 04. 09. 2018, “Për standardet, procedurat dhe kriteret e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, ligjit nr. 8788, datë 07. 05. 2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse” *i ndryshuar*, Marrëveshja ndërmjet; Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, e ratifikuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Strategjisë Kombëtare për Moshimin dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Personat e Moshuar”, Marrëveshja e partneritetit me nr. 2147 prot, datë 14.05.2026 dhe Ralacioni nr. 2237 prot, datë 19.05.2026, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit*, për t’ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes së partneritetit mes Bashkisë Mirditë, përfaqësuar nga Kryetari Z. Albert Mëlyshi & Kooperativës Sociale Vales Scs, përfaqësuar nga Drejtori Z. Paolo Felin & Caritas Dioqezan Rrëshen, përfaqësuar nga Ipeshkëvi Gjergj Meta, për krijimin dhe menaxhimin e Qendrës Ditore për të Moshuarit në Bashkinë Mirditë

ADRESA SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

2. Marrveshja e partneritetit me nr. 2147 prot, datë 14.05.2026 dhe Ralacioni nr. 2237 prot, datë 19.05.2026, *bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi*
3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë identifikimin e objektit dhe kryerjen e të gjitha procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë; (Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksat, Agjencia e Arsimit, Sportit dhe Ndhmës Sociale & Njësia për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Projekteve)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2237/ Prot.

Rrëshen me, 19.05. 2026

P/V E N D I M

Nr. 48 datë 19.05. 2026

PËR

**“MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT MES BASHKISË MIRDITË
TË PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI ALBERT MËLYSHI DHE KOOPERATIVËS
SOCIALE VALES SCS PËRFAQËSUAR NGA DREJTORI Z. PAOLO FELIN DHE
CARITAS DIOQEZAN RRËSHEN PËRFAQËSUAR NGA IPESHKËVI GJERGJ META
PËR KRIJIMIN DHE MENAXHIMIN E QENDRËS DITORE PËR TË MOSHUARIT NË
BASHKINË MIRDITË”.**

Mbështetur në nenet 13, 54, 55, shkronja “dh”, “e” dhe “i”, si dhe nenit 68 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në dispozitat që rregullojnë kontratën e huasë në përdorim (komodato); Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore” (Ndryshuar me ligjin nr. 40/2023, datë 8.6.2023); Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 04.09.2018 “Për standardet, procedurat dhe kriteret e shërbimeve të kujdesit shoqëror”; Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar; Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, ratifikuar me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998; Strategjisë Kombëtare për Moshimin dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Personat e Moshuar; Relacionit të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Këshilli Bashkiak pas diskutimeve në seancë;

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes së partneritetit mes Bashkisë Mirditë të përfaqësuar nga Kryetari Albert Mëlyshi dhe Kooperativës Sociale Vales Scs përfaqësuar nga Drejtori z. Paolo Felin dhe Caritas Dioqezan Rrëshen përfaqësuar nga Ipeshkëvi Gjergj Meta për krijimin dhe menaxhimin e qendrës ditore për të moshuarit në Bashkinë Mirditë.
2. Marrëveshja e partneritetit me nr. 2147 Prot, datë 14.05. 2026 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë identifikimin e objektit dhe kryerjen e të gjitha procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR
Gaspar TOPOLLAJ

KRYETAR
Aleksandër PICA KU

Paraqiti Projektin:

Spektori i Ndihmës Ekonomike-Drejtave dhe Strehimit Social: P/Sek, Gjergj Përgjoni

Njesia e Integritimit Evropian dhe Projekteve: P/Sek, Gjovalin Marfana

Drejtoria Juridike: Juriste, Lorena Gjergji

KRYETARI

Albert MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2237 Prot.

Rrëshen më, 19.05.2026

Lënda: Relacion për projekt-vendimin; Për “MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PARTNERITETI PËR KRIJIMIN DHE MENAXHIMIN E QENDRËS DITORE PËR TË MOSHUARIT NË BASHKINË MIRDITË”.

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË

Të nderuar anëtarë!

Ky projekt-vendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak Mirditë me qëllim krijimin e një Qendre Ditore për të Moshuarit, si një instrument social dhe komunitar në mbështetje të personave të moshuar të vetmuar, pjesërisht jo-autonomë dhe në nevojë për kujdes social ditor. Projekti synon krijimin e një modeli bashkëpunimi ndërmjet pushtetit vendor, institucioneve fetare, organizatave jofitimprurëse dhe partnerëve ndërkombëtarë, në funksion të ofrimit të shërbimeve sociale cilësore dhe të qëndrueshme.

Aktualisht, Bashkia Mirditë nuk disponon një strukturë të specializuar ditore për trajtimin dhe mbështetjen sociale të personave të moshuar të vetmuar ose me nivel të kufizuar autonomie.

Në territor funksionon një pikë ndihme ushqimore e organizuar nga Caritas dhe Motrat e Bamirësisë, e cila ofron çdo ditë vakte të ngrohta për persona në nevojë, por mungon një strukturë e integruar e kujdesit ditor social dhe asistencial për të moshuarit.

Një pjesë e konsiderueshme e kësaj kategorie jeton në kushte izolimi social, me pensione minimale dhe me mungesë të rrjetit familjar mbështetës.

Në territor operojnë aktualisht iniciativa humanitare dhe fetare që ofrojnë ndihmë ushqimore dhe sociale, por mungon një strukturë e integruar dhe e organizuar e kujdesit ditor.

Në këtë kuadër, Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me Caritas Dioqezan Rrëshen dhe partnerin italian “Vales scs”, propozon krijimin e një Qendre Ditore për të Moshuarit.

Qendra Ditore do të funksionojë 5 ditë në javë dhe do të ofrojë:

- shërbime sociale dhe asistenciale;
- higjienë personale të asistuar;
- ushqim dhe mbështetje ushqimore;
- aktivitete socializuese dhe stimuluese;
- mbështetje për familjarët dhe kujdestarët;
- transport për përfituesit sipas nevojave.

Projekti parashikon gjithashtu:

- përfshirjen e vullnetarëve;

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

- zhvillimin e praktikave profesionale për studentët;
- ngritjen e një modeli lokal të mirëqenies sociale.

Projekt-vendimi mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 518, datë 04.09.2018;
- Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar;
- Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë;
- legjislacionin për administrimin e pronës publike dhe ofrimin e shërbimeve sociale.

Bashkia Mirditë do të identifikojë ambiente dhe do të mbulojë një pjesë të kostove operative të projektit, të cilat lidhen kryesisht me:

- energjinë dhe shërbimet bazë;
- transportin;
- personelin;
- mirëmbajtjen;
- mbështetjen ushqimore.

Këto shpenzime do të planifikohen në buxhetin vjetor të bashkisë, sipas parashikimeve financiare dhe në përputhje me legjislacionin për financat vendore.

Partnerët e projektit do të kontribuojnë gjithashtu me investime, pajisje, mbështetje teknike, vullnetarë dhe burime financiare shtesë.

Kooperativa Sociale “Vales scs” do të kontribuojë konkretisht me:

- pajisje për Qendrën Ditore;
- investime për rikonstruksionin e ambienteve;
- mbështetje për transportin;
- mbështetje financiare për promovimin e vullnetarizmit;
- asistencë teknike dhe studime fizibiliteti për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve sociale.

Duke konsideruar rëndësinë sociale të këtij projekti, nevojën reale për shërbime ndaj të moshuarve dhe mundësinë për krijimin e një modeli të qëndrueshëm të kujdesit komunitar në Bashkinë Mirditë, propozohet miratimi i projekt-vendimit përkatës nga Këshilli Bashkiak Mirditë.

Ju faleminderit!

Paraqiti Projektin:

Spektori i Ndihmës Ekonomike-Drejtave dhe Strehimit Social: P/Sek, **Gjergj Përgjoni**

Njesia e Integritimit Evropian dhe Projekteve: P/Sek, **Gjovalin Marfana**

Drejtorja Juridike: Juriste, **Lorena Gjergji**

KRYETARI
Albert MËLLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al